<p>atyre të kryejnë përgjegjësitë e tyre, duke përfshirë identifikimin e shënimeve apo dokumenteve relevante dhe t'i furnizojnë ata me çdo informacion të kërkuar për t'i mundësuar zyrtarët e autorizuar të gjejnë dhe kuptojnë shënimet apo dokumentet e tilla. Personat e tillë gjithashtu ndihmojnë zyrtarët e autorizuar të kenë qasje dhe t'i kopjojnë apo riprodhojnë shënimet dhe dokumentet që mirëmbahen në mënyrë elektronike dhe lejojnë përdorimin e çdo pajisjeje për kopjim të vendosur në objekt.</p> <p>5. Personi në ndërtesat që janë subjekt i një inspektimi mund të refuzojë të lejojë inspektimin ose kopjimin e një shënimi ose dokumenti nëse vlerëson se:</p> <p>5.1. nuk është i mbajtur në përputhje me dispozitat nga neni 16 deri te neni 32 të këtij ligji, dhe nuk është relevante për përcaktuar nëse detyrimet sipas dispozitave nga neni 16 deri te neni 32 të këtij ligji të këtij ligji janë përmbushur; ose</p> <p>5.2. përmban informacion që është subjekt i privilegjit avokat-klient.</p> <p>6. Në rast të një refuzimi të tillë, një zyrtar i autorizuar që kryen inspektimin vendos shënimin apo dokumentin e kontestuar në një zarf ose kuti tjetër të përshtatshme, e cila mbyllet në prani të personit apo përfaqësuesit të tij, dhe do të firmoset nga zyrtari dhe personi/përfaqësuesi. Shënimi apo dokumenti i mbyllur paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve para</p>	<p>enable them to carry out their responsibilities, including identifying the relevant records or documents and providing any information requested to enable the authorised officials to locate and understand such records or documents. Such persons shall also assist the authorised officials in accessing and copying or reproducing records and documents maintained electronically, and shall permit the use of any copying equipment located on the premises.</p> <p>5. A person in premises subject to an inspection may refuse to allow the inspection or copying of a record or document if he or she asserts that:</p> <p>5.1. it is not held pursuant to provisions of Articles 16 to 32 of this Law and is not relevant to determining whether obligations under provisions of Articles 16 to 32 of this law have been complied with; or</p> <p>5.2. it contains information that is subject to lawyer-client privilege.</p> <p>6. In the event of such refusal, an authorised official conducting the inspection shall place the disputed record or document in an envelope or other appropriate container, which shall be sealed in the presence of the person or his or her representative, and signed by the official and the person or representative. The sealed record or document shall be presented</p>	<p>relevantnih podataka ili dokumenata i da im obezbede sve potrebne informacije za omogućavanje ovlašćenim službenicima da nađu i saznaju za takvu vrstu evidencije ili dokumentacije. Te osobe takođe pomažu ovlašćenim službenim licima pristup na kopiranje ili obnovi evidencije i dokumentacije koja se vodi na elektronski način i omogućava korišćenje bilo koje opreme za umnožavanje koja se nalazi u tim prostorijama.</p> <p>5. Osoba, koja je predmet inspekcije u objektima, može odbiti da dozvoli inspekciju ili kopiranje evidencije ili dokumenta, ako utvrdi da:</p> <p>5.1. nije vođena u skladu sa odredbama od člana 16. do člana 32. ovog zakona, i nije relevantan za utvrđivanje da li su ispunjene obaveze u skladu sa odredbama od člana 16. do člana 32. ovog zakona; ili</p> <p>5.2. sadrži informacije koje su predmet privilegije advokat-klijent.</p> <p>6. U slučaju takvog odbijanja, ovlašćeno službeno lice koje vodi inspekciju, stavlja podatak ili sporni dokumenat u koverat ili drugu odgovarajuću kutiju, koja se zatvara u prisustvu lica ili njegovog zastupnika, i potpisuje se od strane službenika i lica / predstavnika. predmet ili zatvoreni dokumenat dostavlja se u roku od deset (10) dana kod</p>
---	---	---

<p>një gjykatësi të procedurës paraprake të gjykatës kompetente, i cili do të inspektojë atë, dhe të përcaktojë nëse ai, apo ndonjë pjesë e tij, i nënshtrohet inspektimit dhe kopjimit sipas këtij neni.</p> <p>7. Në qoftë se një person mendon se ka qenë subjekt i inspektimit të paligjshme, mund të paraqesë ankesë brenda 30 ditëve që nga dita e inspektimit te gjykatësi i procedurës paraprake të gjykatës kompetente, i cili gjykon ligjshmërinë e veprimeve të përmendura në ankesë dhe vendosë për kompensim kur është e përshtatshme. Zyrtarët e autorizuar të NjIF-K sigurojnë për gjykatësit hetues dokumente të tilla të kërkuara dhe sipas kërkesës, ofrojnë dëshmi gojore.</p>	<p>within ten (10) days to a Pre Trial Judge of the competent Court, who shall inspect it, and determine whether it, or any part of it, is subject to inspection and copying pursuant to this article.</p> <p>7. If a person considers that he or she has been the subject of actions which are unlawful, he or she may submit a complaint within thirty (30) days of the inspection to a Pre Trial Proceeding Judge of the competent Court who shall adjudicate on the lawfulness of the actions referred to in the complaint and decide on compensation where appropriate. Authorized officials of the FIU-K shall provide to the investigating judge with such documents as he or she shall request and shall, on request, provide oral testimony.</p>	<p>predpretnog sudije nadležnog suda, koji će izvršiti inspekciju i koji će utvrditi da li on, ili bilo koji njegov deo, podleže inspekciji i kopiranju prema ovom članu.</p> <p>7. Ako neka osoba smatra da je predmet nezakonite inspekcije, može uložiti žalbu u roku od 30 dana od dana inspekcije pretpretnog sudije nadležnog suda, koji razmatra osnovanost navoda u žalbi i odlučuje o naknadi gde je to moguće. Ovlašćeni službenici FOJ-K obezbeđuju istražnom sudiji zatražene dokumente i po zahtevu daju usmenu izjavu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 36 Inspektimi i pajtueshmërisë në vend nga BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial</p> <p>1. BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë me mandat mbikëqyrës sipas paragrafit 4 dhe 5 të nenit 34, për qëllime të mbikëqyrjes së subjekteve raportuese për sa i përket pajtueshmërisë me këtë ligj dhe me rregullat dhe rregulloret përkatëse, zbatojnë kompetenca të tilla të mbikëqyrjes së kujdesit ashtu si iu janë dhënë me ligjin përkatës, në mënyrë që të jenë të zbatueshme në përmbushjen e mandatit të tyre mbikëqyrës sipas këtij ligji, me përjashtim të kompetencës për mbikëqyrje të subjekteve raportuese për sa i përket pajtueshmërisë lidhur me obligimet e</p>	<p style="text-align: center;">Article 36 On-site Compliance Inspection by CBK and Other Sectorial Supervisors</p> <p>1. CBK and other sectorial supervisors with a supervisory mandate in accordance with paragraph 4 and 5 of Article 34, for the purposes of supervising thereporting entity with regards to the compliance with this Law and with related rules and regulations and who have a prudential supervisory mandate conferred upon them through specific laws for such reporting entities shall apply such prudential supervisory powers as are conferred upon them by the respective laws, if they are applicable for exercising the supervisory mandate pursuant to this Law, with the</p>	<p style="text-align: center;">Član 36 Inspekcija usaglašenosti na mestu od CBK i drugi sektorski nadzornici</p> <p>1. CBK i drugi sektorski nadzornici sa nadzornim mandatom iz stava 4. i 5. člana 34., u cilju nadzora izveštajnih subjekata u vezi sa usaglašenošću sa ovim zakonom i pravilima i odgovarajućim pravilnicima, sprovode takva ovlašćenja nadzora zaštite, koja su određena relevantnim zakonom, kako bi bile primenljive za ispunjenjavanje njihovog nadzornog mandata prema ovom zakonu, osim nadležnosti za kontrolu izveštajnih subjekata u vezi usaglašenosti sa obavezama utvrženih u članu 26. ovog zakona.</p>

<p>përcaktuara në nenin 26 të këtij ligji.</p> <p>2. Aty ku kompetenca të tilla mbikëqyrëse nuk janë të parashikuara nga ligji i veçantë, zbatohen dispozitat e kompetencave mbikëqyrëse të NjIF-K-it të përcaktuara në paragrafin 2,4,5,6 dhe 7 në nenin 35 të këtij ligji.</p>	<p>exception of the competences for supervision of the reporting entities regarding the compliance with the obligations set in Article 26 of this Law.</p> <p>2. Where such supervisory competences are not contemplated by a special law, the provisions of supervisory competencies of FIU-K set in paragraphs 2,4,5,6 and 7 in Article 35 of this Law shall be applied.</p>	<p>2. Tamo gde takve nadležnosti nadzorna nisu predviđena posebnim zakonom, sprovode se odredbe nadležnosti nadzora FOJ-K iz stava 2,4,5,6 i 7 člana 35. ovog zakona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 37 Mbikëqyrja nga distanca</p> <p>1. Për qëllime të monitorimit dhe mbikëqyrjes nga distanca të subjekteve raportuese për vlerësimin e pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji ose çfarëdo rregulle ose rregulloreje të nxjerrë në përputhje me këtë ligji, NjIF-K dhe BQK mundën përmes një njoftimi me shkrim të dërguar subjektit raportues, të kërkojnë që subjekti raportues të paraqesë, brenda kohës dhe në mënyrën e specifikuar në atë njoftim, çfarëdo dokumentacioni, përfshirë ato të lidhura me procedurat e brendshme sipas këtij ligji ose çfarëdo rregulloreje për të përmbushur përgjegjësitë e tyre sipas këtij ligji, dhe dispozitat e paragrafëve 3,4 dhe 5 të nenit 35 zbatohen në përputhje me situatën.</p> <p>2. Mbikëqyrësit e tjerë sektorialë mund të kryejnë mbikëqyrje nga distanca, nëse kjo kompetencë i është dhënë në pajtim me paragrafin 5 të nenit 34.</p>	<p style="text-align: center;">Article 37 Off-Site Supervision</p> <p>1. For the purposes of undertaking off-site supervision and monitoring of the reporting entities for assessing the compliance with the provisions of this Law of any rule or regulation issued in accordance with this Law, FIU-K and CBK may, by notice in writing served on a Reporting entity , require that the reporting entity to produce, within the time and at a place as may be specified in that notice, any documents, including those related to internal procedures under this Law or any regulation issued to fulfil their responsibilities under this Law, and provisions of paragraphs 3,4 and 5 of article 35 shall be applied in accordance with the situation.</p> <p>2. Other sectorial supervisors may conduct off-site supervision, if this competence was given to them in accordance with paragraph 5 of Article 34.</p>	<p style="text-align: center;">Član 37 Daljinski nadzor</p> <p>1. Za potrebe praćenja i daljinskog nadzora od strane izveštajnih subjekata za procenu usklađenosti sa odredbama ovog zakona ili bilo kog pravila ili pravilnika u skladu sa ovim zakonom, FOJ-K i CBK može preko poslatog pismenog obaveštenja izveštajnom subjektu, zatevati od izveštajnih subjekata da podnese, u roku i na način predviđen u tom obaveštenju, svu dokumentaciju, obuhvaćajući i onu koja se odnosi na interne postupke po ovom zakonu ili bilo kojim pravilnikom da ispune svoje obaveze prema ovom zakonu, i da se odredbe stava 3. 4.i 5.člana 35. primenjuju u skladu sa situacijom.</p> <p>2. Drugi sektorski nadzornici mogu obavljati daljinski nadzor, ako im je ova nadležnost data u skladu sa stavom 5. člana 34.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 38 Bashkëpunimi për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë</p>	<p style="text-align: center;">Article 38 Co-operation on Compliance Supervision</p>	<p style="text-align: center;">Član 38 Saradnja za nadzor usaglašenosti</p>
<p>1. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë bashkëpunojnë dhe koordinojnë aktivitetet e tyre për mbikëqyrje të pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji në lidhje me:</p> <p>1.1. Planifikimin dhe implementimin e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;</p> <p>1.2. Aktivitetet e përbashkëta të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë në vend dhe në distancë;</p> <p>1.3. Dokumentacionin, vlerësimin, raportimin dhe monitorimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;</p> <p>1.4. Ndëshkimin administrativ dhe masat e tjera mbikëqyrëse; dhe</p> <p>1.5. Vlerësimin dhe aktivitetet pasuese të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë.</p> <p>2. BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë, kur gjatë kryerjes së detyrave brenda kompetencave të tyre dyshojnë apo identifikojnë aktivitete që janë ose mund të jenë të lidhura me pastrimin e parave dhe financim të terrorizmit, informojë menjëherë me shkrim NjIF-K.</p> <p>3. BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë, informojë me shkrim NjIF-K për të gjitha</p>	<p>1. FIU-K, CBK and other sectorial supervisors shall co-operate and co-ordinate their activities for compliance supervision with the provisions of this Law in connection with:</p> <p>1.1. Planning and implementation of compliance supervision;</p> <p>1.2. Joint activities of compliance supervision on-site and off-site;</p> <p>1.3. Documentation, assessment, reporting and monitoring of activities of compliance supervision;</p> <p>1.4. Administrative sanction and other supervision measures; and</p> <p>1.5. Assessment and follow up activities of compliance supervision.</p> <p>2. CBK and other sectorial supervisors, when during the exercise of the duties within their competences suspect of or identify activities which are or which may be associated with money laundering and terrorist financing, shall immediately inform FIU-K in writing.</p> <p>3. CBK and other sectorial supervisor shall immediately inform FIU-K in writing on all</p>	<p>1. FOJ-K CBK i drugi sektorski nadzornici saraduju i koordiniraju svoje aktivnosti za praćenje usaglašenosti sa odredbama ovog zakona u vezi sa:</p> <p>1.1. Planiranjem i sprovođenjem nadzora usaglašenosti;</p> <p>1.2. Zajednički nadzor aktivnosti usaglašenosti na lice mesta i udaljenosti;</p> <p>1.3. Dokumentacija, ocenjivanje, izveštavanje i praćenje nadzora aktivnosti usaglašenosti;</p> <p>1.4. Administrativna kazna i druge mere nadzora; i</p> <p>1.5. Procena i praćenje aktivnosti nadzora usaglašenosti.</p> <p>2. CBK i drugi sektorski nadzornici, ako tokom obavljanja zadataka u okviru njihovih ovlašćenja sumnjaju ili identifikuju aktivnosti koje su ili mogu biti povezane sa pranjem novca ili finansiranje terorizma, odmah informišu pismeno FOJ-K.</p> <p>3. CBK i drugi sektorski nadzornici, pismeno informišu FOJ-K za sve preduzete mere za</p>

<p>masat e marra për zbatimin e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë dhe i dërgojë NjIF-K një kopje të çdo raporti që ata lëshojnë subjektit raportues, jo më vonë se tri (3) ditë nga data e lëshimi i tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 39 Të dhënat statistikore dhe informatat kthyese</p> <p>1. NjIF-K, BQK, mbikëqyrësit e tjerë sektorialë me të cilët NjIF-K ka hyrë në marrëveshje specifike individuale sipas paragrafit 5 të nenit 34 të këtij ligji, autoritetet e tjera kompetente që kanë përgjegjësi për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, subjektet raportuese si dhe personat ose subjektet e tjera që kanë detyrime ose funksione sipas këtij ligji mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë.</p> <p>2. Në mbajtjen e të dhënave statistikore, personat, subjektet dhe autoritetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni ndër veprojnë me NjIF-K e cila, në bashkëpunim me BQK ose mbikëqyrësit e tjerë sektorialë, sipas rastit, mund të përcaktojë llojin e të dhënave statistikore që mund të kërkohen.</p> <p>3. Për këtë qëllim, NjIF-K, BQK ose mbikëqyrësi sektorial, nxjerrin akte nënligjore, urdhra ose udhëzime për mbajtjen e statistikave të atyre sektorëve nën fushëveprimin e tyre mbikëqyrës në pajtim me paragrafin 2 të nenit</p>	<p>measures undertaken for the implementation of compliance supervision and shall submit to FIU-K a copy of each report they issue to the Reporting entity, no later than three (3) days from the date of their issuance.</p> <p style="text-align: center;">Article 39 Statistical Data and feedback</p> <p>1. FIU-K, CBK, and other sectorial supervisors with whom the FIU-K has entered into specific individual arrangements pursuant to paragraph 5 of article 34 of this Law and other competent authorities with a responsibility for combating money laundering and the financing of terrorism, reporting entities as well as persons or other entities with obligations or functions in accordance with this Law shall maintain relevant comprehensive statistical data on their area of responsibility.</p> <p>2. In maintaining statistical data, persons, entities and authorities referred to in paragraph (1) of this Article shall liaise with FIU-K which, in co-operation with the CBK or other relevant sectorial supervisors, as the case may be, may determine the type of statistical data that may be required.</p> <p>3. To this effect, the FIU-K, the CBK or a sectoral supervisory authority shall issue sub legal acts on the maintenance of statistics to those sectors under their supervisory remit pursuant to paragraph (2) of Article 66.</p>	<p>sprovodenje nadzora usaglašenosti i FOJ-K dostavljaju jednu kopiju svakog izveštaja koji oni izdaju za izveštajni subjekat, najkasnije u roku od tri (3) dana od dana njihovog izdavanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 39 Statistički podaci i povratne informacije</p> <p>1. FOJ-K, CBK, i drugi sektorski nadzornici sa kojima je FOJ-K stupila u specifične pojedinačne sporazume prema stavu 5. člana 34. ovog zakona, drugi nadležni organa koji su odgovorni za borbu protiv pranja novca i finansiranja terorizma izveštajni subjekti i druga lica ili subjekti koji imaju obaveze ili obaveze prema ovom zakonu vode sveobuhvatne statističke podatke od značaja iz oblasti njihove odgovornosti.</p> <p>2. U vođenju statističkih podataka, lica, subjekti i navedeni organi iz stava 1. ovog člana sarađuju sa FOJ-K koja, u saradnji sa CBK ili drugim sektorskim nadzornicima, gde je to moguće, može odrediti vrstu statističkih podataka koji se mogu zahtevati.</p> <p>3. U tom pravcu, FOJ-K CBK ili sektorski nadzornik, donose podzakonske akte, naredbe i uputstva u vezi vođenja statističkih podataka u onim sektorima iz njihovog delokruga nadzora i u skladu sa stavom 2. člana 66.</p>
---	---	---

<p>66.</p> <p>4. Të dhënat statistikore të mbajtura sipas këtij neni vihen në dispozicion të NjIF-K brenda afateve kohore të përcaktuara prej NjIF-K, për t'i mundësuar që të rishikojë efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime në përputhje me rrethanat siç kërkohet sipas neni 14 të këtij ligji.</p> <p>5. NjIF-K do të njoftoj subjektet raportuese, që kanë raportuar në NjIF-K një person ose transaksion në lidhje me të cilën ka pasur arsye për të dyshuar për pastrim parash apo terrorizmit financimi, lidhur me rezultatet të sjella nga raportimi i tyre.</p> <p>6. Njoftimi i përmendur në paragrafin 5 të këtij neni do të aplikohet për:</p> <p>6.1. të dhënat për numrin e raporteve të dërguara për transaksionet ose personave për të cilat ka arsye për të dyshuar lidhur me pastrimin e parave ose financim të terrorizmit;</p> <p>6.2. Rezultatet e sjella nga raportimi i tillë, kur është e aplikueshme;</p> <p>6.3. informatat për trendet dhe teknikat lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;</p> <p>7. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë sipas këtij neni bashkëpunojnë për qëllime të përmbushjes së përgjegjësisë të tyre</p>	<p>4. Statistical data maintained under this Article shall be made available to the FIU-K within time periods as the FIU-K may determine to enable it to review the effectiveness of the national system and to make recommendations accordingly as required under Article 14 of this Law.</p> <p>5. The FIU-K shall inform the reporting entities, that reported to the FIU-K a person or transaction with respect to which there are reasons for suspicion of money laundering or terrorism financing, of the results brought about by their reporting.</p> <p>6. The notice referred to in paragraph 5 of this Article shall apply to:</p> <p>6.1. data on the number of the sent reports on transactions or persons in relation to which there are reasons for suspicion of money laundering or terrorism financing;</p> <p>6.2. results brought about by such reporting; where applicable;</p> <p>6.3. information on trends and techniques related to money laundering and terrorist financing;</p> <p>7. The FIU-K, the Central Bank of Kosovo and other sectoral supervisors under this Article shall cooperate for the purposes of fulfilling</p>	<p>4.Statistički podaci koji se čuvaju po ovom članu moraju biti dostupni za FOJ-K u okviru određenih rokova od strane FOJ-K, kako bi se omogućilo preispitivanje efikasnosti nacionalnih sistema i o tome daju preporuke kako je zahtevano u članu 14.ovog zakona.</p> <p>5.FOJ-K će informisati sve subjekte izvestioce koji su izveštavali u FOJ-K jednu osobu ili transakciju u vezi sumnji o ispiranju novca ili finansiranje terorizma, vezana sa prikazanim rezultatima iz njihovog izveštaja.</p> <p>6.Navedena informacija u stavu 5 ovog člana primeni će se za :</p> <p>6.1.podatke o broju poslatih izveštaja za tranaskcije ili lica za koja postoji osnovana sumnja o ispiranju novca ili finansiranju terorizma.</p> <p>6.2. Poslati rezultati iz takvog itveštavanja kada je primenljivo.</p> <p>6.3. Informacije o tendovima ili tehnikama u vezi ispiranja novca ili finansiranja terorizma .</p> <p>7.FOJ-K, CBK i drugi sektorski nadzornici prema ovom članu sarađuju u cilju ispunjenja njihovih odgovonosti prema ovom članu.</p>
---	--	--

<p>nën këtë nen.</p> <p>KAPITULLI V NDËSHKIMET ADMINISTRATIVE DHE MASA PËR PËRMIRËSIM</p> <p style="text-align: center;">Neni 40 Ndëshkimet Administrative</p> <p>Dështimi nga subjektet raportuese të definuar në nenin 16 të këtij ligji, për t'iu përmbajtur obligimeve ligjore të parashikuara në këtë ligj, që nuk janë vepra penale, përbëjnë shkelje administrative të cilat klasifikohen si shkelje shumë të rënda, shkelje të rënda dhe shkelje të lehta.</p> <p style="text-align: center;">Neni 41 Shkelje shumë të rënda</p> <p>1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji si në vijim do të përbëjnë shkelje shumë të rënda:</p> <p>1.1. Dështimi për të përmbushur detyrimet e raportimit të përcaktuara në nenin 26;</p> <p>1.2. Dështimi për të përmbushur detyrimin për të bashkëpunuar në bazë të paragrafit 1.4 të nenit 14 pas kërkesës zyrtare me shkrim nga NjIF-K;</p> <p>1.3. Dështimi për të përmbushur detyrimet e paragrafit 1.12 të nenit 14;</p>	<p>their responsibilities under this Article.</p> <p>CHAPTER V ADMINISTRATIVE SANCTIONS AND REMEDIAL MEASURES</p> <p style="text-align: center;">Article 40 Administrative Sanctions</p> <p>The failure of the reporting entities specified in Article 16 of this Law to comply with legal obligations prescribed in this Law, which are not criminal offence, shall constitute administrative violations, which are classified as very serious violations, serious violations and minor violations.</p> <p style="text-align: center;">Article 41 Very serious violations</p> <p>1. The following violations of the provisions of this Law shall constitute very serious violations:</p> <p>1.1. Failure to comply with the reporting obligations defined in Article 26;</p> <p>1.2. Failure to comply with the obligation to co-operate on the basis of paragraph 1.4 of Article 14 following the official written request made by FIU-K;</p> <p>1.3. Failure to comply with the obligations of paragraph 1.12 of article 14;</p>	<p>POGLAVLJE V ADMINISTRATIVNE SANKCIJE I MERE POBOLJŠANJA</p> <p style="text-align: center;">Član 40 Administrativne sankcije</p> <p>Neuspeh izveštajnih subjekata koji su definisani u članu 16. ovog zakona, radi pridržavanja zakonskih obaveza predviđenih u ovom zakonu, koja nisu krivična dela, i predstavljaju administrativne povrede koje su klasifikovane kao veoma teške povrede, ozbiljni povrede i lakši povrede.</p> <p style="text-align: center;">Član 41 Veoma teške administrativne povrede</p> <p>1. povrede odredaba ovog zakona kao što je navedeno u nastavku predstavljaju veoma ozbiljne povrede</p> <p>1.1. Neispunjavanje obaveza izveštavanja propisanih u članu 26.;</p> <p>1.2. Neuspeh u ispunjavanju obaveza da sarađuju u skladu sa stavom 1.4. člana 14. nakon formalnog pismenog zahteva od strane FOJ-K;</p> <p>1.3. Neuspeh u ispunjavanju obaveza iz stava 1.12. član 14.;</p>
--	--	--

<p>1.4. Dështimi në përputhje me detyrimin për të ndërmarrë veprime përmirësuese sipas rekomandimit zyrtar të NjIF-K, BQK ose mbikëqyrësve të tjerë sektorial të lëshuar pas mbikëqyrjes së pajtueshmërisë siç definohet në nenin 34 në rast të mosgatishmërisë për të përmbushur rekomandimin.</p> <p>1.5. Përsëritja e shkeljes së rëndë për të cilën subjektit raportues i është shqiptuar sanksion administrativ gjatë pesë (5) vjetëve të fundit për të njëjtin lloj të shkeljes; dhe</p> <p>1.6. Shkelje të detyrimit për të ngrirë ose të bllokuar fondet siç përcaktohet në nenin 27.</p>	<p>1.4. Failure to comply with the obligation to undertake remedial actions according to the official recommendation of FIU-K, CBK or other sectorial supervisors issued after the compliance supervision as defined in article 34, in case of non compliance with the recommendation.</p> <p>1.5. Repetition of a serious violation for which an administrative sanction was imposed to the reporting entity during five (5) last years for the same nature of violation; and</p> <p>1.6. Violation of the obligation to freeze or block funds as defined in article 27.</p>	<p>1.4. Neuspeh u odnosu na obavezu za preduzimanje mera za poboljšanje date u zvanične preporuke FOJ-K, CBK ili drugih sektorskih nadzornika i izdate nakon nadzora usaglašenosti kao što je predviđeno u članu 34. u slučaju nespremnosti za ispunjavanje preporuke.</p> <p>1.5. Ponavljanje ozbiljne povrede zbog koje je u izveštajnom subjektu izrečena administrativna sankcija tokom pet (5) zadnjih godina za istu vrstu ozbiljne povrede; i</p> <p>1.6. Povreda obaveze o zamrzavanju ili blokiranju sredstva kao što je predviđeno u članu 27.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 42 Ndëshkimet për shkeljet shumë të rënda</p>	<p style="text-align: center;">Article 42 Sanctions for very serious violations</p>	<p style="text-align: center;">Član 42 Kazne za veoma ozbiljne povrede</p>
<p>1. Për shkeljet shumë të rënda të përcaktuara në nenin 41, NJIF-K mund të shqiptojë ndëshkim administrativ siç definohet në vijim:</p> <p>1.1. Vërejtje Publike;</p> <p>1.2. Gjobënë shumë prej :</p> <p>1.2.1 në një minimum prej pesëdhjetëmijë (50.000) euro;</p> <p>1.2.2 një shumë maksimale që mund të vendoset deri në lartësinë më të madhe të këtyre shifrave: 10% të vlerës neto të</p>	<p>1. FIU-K may impose an administrative sanction for very severe violations defined in article 41, as follows:</p> <p>1.1. Written public warning;</p> <p>1.2. A fine in amount of</p> <p>1.2.1. a minimum of € fifty thousand (50.000)</p> <p>1.2.2. a maximum amount that can be set up to a higher amount of these figures: 10% of the net worth of the reporting</p>	<p>1. Za veoma ozbiljne povrede propisane u članu 41., FOJ-K može da izrekne administrativna kaznu kako je predviđeno u nastavku:</p> <p>1.1. Javna opomena;</p> <p>1.2. Kazna u iznosu od:</p> <p>1.2.1 najmanje pedeset hiljada (50.000) evra-</p> <p>1.2.2.i jedan maksimalni iznos koji može da se izrekne do visine najvećeg iznosa ovih brojki: 10% neto zarade subjekta izvestioca,</p>

<p>subjektit raportues, sipas llogarive më të fundit në dispozicion të aprovuara nga bordi menaxhues, por jo më pak se pesëdhjetëmijë (50.000) euro,</p> <p>1.2.3. dy herë vëllimin ekonomik të transaksionit, por jo më pak se pesëdhjetëmijë (50.000) euro;</p> <p>1.2.4 deri në pesëqind mijë euro (500.000) apo</p> <p>1.2.5. deri në një milion (1.000.000) euro për bankat dhe institucionet financiare.</p> <p>1.3. Në rastin e institucioneve që kërkohet licencë, certifikatë apo çfarëdo autorizim administrativ për funksionimin e tyre, mund të kërkohet tërheqja e licencës, certifikatës apo autorizimit. Ndëshkimi i paraparë në paragrafin 1.2., i cili do të jetë i detyrueshëm në të gjitha rastet, vendosen në të njëjtën kohë me një nga ato të listuara në paragrafin 1.1 dhe në paragrafin 1.3.</p> <p>2. Përveç ndëshkimit të zbatueshme që shqiptohet për subjektin raportues për shkeljet shumë të rënda, një ose më shumë nga ndëshkimet e mëposhtme mund të shqiptohet për personat fizik që janë përgjegjës për shkeljen dhe që mbajnë poste administrative apo menaxhuese në subjektin raportues:</p> <p>2.1. gjobë për secilin prej tyre prej njëzetmijë (20.000) euro deri në dyqind mije (200.000) euro;</p>	<p>entity according to the latest accounts available approved by the Management Board, but not less than fifty thousand (50,000) euros</p> <p>1.2.3. two times the economic volume of transaction, but not less than fifty thousand (50,000) euros</p> <p>1.2.4. up to five hundred thousand (500,000) euros or</p> <p>1.2.5. up to one € million (1.000.000) for the banks and financial institutions.</p> <p>1.3. In the case of institutions requiring licence, certificate or whatever administrative authorisation for their operation, withdrawal of this authorisation may be requested. A fine provided under paragraph 1.2. which will be compulsory in all events, may be imposed simultaneously with one of those listed under paragraph 1.1 and in paragraph 1.3.</p> <p>2. Except the fine applicable imposed on the reporting entity for very serious violations, one or more of the following sanctions may be imposed to natural persons responsible for violation and who are holding administrative or managing posts in the reporting entity:</p> <p>2.1. A fine for each of them in the amount of € twenty thousand (20.000) up to € two hundred thousand (200.000);</p>	<p>prema poslednjim raspoloživim računima usvojenih od strane upravnog Odbora, ali ne manje od pedesetjiljada (50.000) evra</p> <p>1.2.3. dva puta obim ekonomske transakcije, ali ne manje od pedesetjiljada (50.000)</p> <p>1.2.4 do petstohiljada (500.000) evra ili</p> <p>1.2.5 do jedan milion (1.000.000) evra za banke i finansijske institucije.</p> <p>1.3. U slučaju institucija za koja se zahteva licenciranje, uverenje ili bilo koje administrativno ovlašćenje za njihovo funkcionisanje, može se tražiti oduzimanje licence, potvrde ili ovlašćenja. Kazna predviđena u stavu 1.2., koja će biti obavezujuća u svim slučajevima, izriče se istovremeno sa jednom od onih koje su navedene u stavu 1.1. i u stavu 1.3.</p> <p>2. Osim primenjlive kazne koja se izriče izveštajnom subjektu za veoma ozbiljne prekršaje, jedna ili više dolenevedena kazna se može izreći fizičkim licima koja su odgovorna za povrede i koji imaju menadžerski ili administrativni položaj u izveštajnom subjektu:</p> <p>2.1. kazna za svakog od njih u iznosu od dvadeset hiljada (20.000) evra do dvesta hiljade (200.000) evra;</p>
--	--	---

<p>2.2. Largimi nga detyra, me diskualifikimin nga mbajtja e pozitave administrative apo menaxhuese në të njëjtin subjekt raportues për një periudhë maksimale prej dhjetë (10) vjetësh;</p> <p>2.3. Largimi nga detyra me diskualifikimin nga mbajtja administrative apo menaxhim në pozicionet në çdo subjekt raportues për një periudhë maksimale prej dhjetë (10) vjetësh.</p> <p>3. Ndëshkimi i parashikuar në paragrafin 2.1, i cili do të jetë i detyrueshëm në të gjitha rastet, mund të shqiptohet në të njëjtën kohë me një nga ato të listuara në paragrafët 2.2. dhe 2.3.</p>	<p>2.2. Dismissal from duty with disqualification from the holding of administrative or managing positions in the same reporting entity for a maximum period of ten (10) years;</p> <p>2.3. Dismissal from duty with disqualification from the holding of administrative or managing positions in all reporting entities for a maximum period of ten (10) years.</p> <p>3. The penalty envisaged under paragraph 2.1, which will be compulsory in all events, may be simultaneously imposed with one of those listed in paragraphs 2.2 and 2.3.</p>	<p>2.2. Otpuštanje sa posla, diskvalifikacija iz držanja administrativnih ili menadžerskih pozicija u istom izveštajnom subjektu za period od najviše deset (10) godina.</p> <p>2.3. Otpuštanje sa posla, diskvalifikacija iz držanja administrativnih ili menadžerskih pozicija u bilo kom izveštajnom subjektu za period od najviše deset (10) godina.</p> <p>3. Predviđena kazna u stavu 2.1., koja će biti obavezna u svim slučajevima, može se istovremeno izreči sa jednom predvedenom kaznom u stavu 2.2. i 2.3.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 43 Shkelje të rënda</p> <p>1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji si në vijim paraqesin shkelje të rënda:</p> <p>1.1. Dështimi në përputhje me detyrimin që të nxirren politika dhe procedura të brendshme të shkruara në vendosjen kontrolleve për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe në zbatimin e tyre siç përcaktohet në nenin 17;</p> <p>1.2. Mos përmbushja e obligimeve formale të identifikimit, siç përcaktohet në nenin 19;</p>	<p style="text-align: center;">Article 43 Serious Violations</p> <p>1. Violations of the following provisions of the law constitute serious violations:</p> <p>1.1. Failure to comply with the obligation to issue written policies and internal procedures in setting controls for prevention and detection of money laundering and terrorist financing and their implementation as set under the terms of Article 17;</p> <p>1.2. Failure to comply with formal identification obligations under the terms of</p>	<p style="text-align: center;">Član 43 Teške povrede</p> <p>1. Povreda odredbi iz ovog zakona kako je navedeno u nastavku predstavljaju teške povrede:</p> <p>1.1. Neispunjavanje u skladu sa obavezom za uspostavljanje unutrašnje politike i previđenih postupaka za uspostavljanje kontrole za sprečavanje i otkrivanje pranja novca i finansiranja terorizma i njihovu primenu kako je utvrđeno članom 17;</p> <p>1.2. Neuspunjavanje formalnih obaveza identifikacije, kako je određeno u članu 19;</p>

<p>1.3. Dështimi për të përmbushur detyrimet për të identifikuar pronarin përfitues, siç përcaktohet në paragrafin 1.2 të nenit 19;</p> <p>1.4. Dështimi në përputhje me detyrimin e marrjes së informacionit mbi qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies së biznesit siç përcaktohet në paragrafin 1.3 të nenit 19;</p> <p>1.5. Dështimi në përputhje me detyrimin e zbatimit të masave për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit, sipas kushteve të paragrafit 1.4 të nenit 19;</p> <p>1.6. Dështimi për të përmbushur detyrimin e aplikimit të masave të kujdesit të duhur për klientët ekzistues siç përcaktohet në dispozitat kalimtare, sipas paragrafit 1 të nenit 68;</p> <p>1.7. Mos përmbushja e detyrimit të aplikimit të masave të kujdesit të duhur të shtuar, siç përcaktohet në nenin 22;</p> <p>1.8. Mos përmbushja e detyrimin të monitorimi special të transaksioneve të veçanta, siç përcaktohet në neni 25;</p> <p>1.9. Dështimi në përputhje me detyrimin e vlerësimit të rrezikut, siç përcaktohet në nenin 18;</p> <p>1.10. Dështimi në përputhje me detyrimin e raportimit tek NjIF-K, siç përcaktohet në</p>	<p>Article 19;</p> <p>1.3. Failure to comply with the obligations for identification of the beneficial, under the terms of paragraph 1.2 of Article 19;</p> <p>1.4. Failure to comply with the obligation to obtain information on the purpose and the nature of business relationship, under the terms of 1.3 of Article 19;</p> <p>1.5. Failure to comply with the obligation of the implementation of measures for on-going monitoring of business relationship, under the terms of paragraph 14 of Article 19;</p> <p>1.6. Failure to comply with the obligation in applying the measures of due diligence for the existing clients as defined under the transitional provisions, under the terms of paragraph 1 or article 68;</p> <p>1.7. Failure to comply with the obligation in applying the measures of enhanced due diligence, under the terms of Article 22;</p> <p>1.8. Failure to comply with the obligation of special monitoring of certain transactions, as defined under the terms of Article 25;</p> <p>1.9. Failure to comply with the obligation of risk assessment, as defined under the terms of Article 18;</p> <p>1.10. Failure to comply with the obligation of reporting to FIU-K, as defined under</p>	<p>1.3. Neuspunjavanje obaveze za identifikaciju vlasnika korisnik, kao što je utvrđeno u stavu 1.2. člana 19;</p> <p>1.4. Neuspunjavanje obaveza o dobijanju informacija o cilju i prirodi poslovnog odnosa kao što je predviđeno u stavu 1.3. člana 19;</p> <p>1.5. Neuspunjavanje obaveza o primeni mera za kontinuirano praćenje poslovnog odnosa pod uslovima iz stava 1.4. člana 19;</p> <p>1.6. Neispunjavanje obaveza o primeni potrebnih mera odgovarajuće brige za postojeće klijente kao što je predviđeno u prelaznim odredbama iz stava 1. člana 68;</p> <p>1.7. Neispunjavanje obaveze za primenu dodatne odgovarajuće brige prema klijentu, kao što je propisano u članu 22;</p> <p>1.8. Neispunjavanje obaveze za specijalno praćenje posebnih transakcija, kao što je propisano u članu 25;</p> <p>1.9. Neuspunjavanje obaveze za procenu rizika, kao što je propisano u članu 18;</p> <p>1.10. Neuspunjavanje obaveze izveštavanja kod FOJ-K kao, kao što je propisano u stavu</p>
---	--	--

<p>paragrafin 9 të nenit 19;</p> <p>1.11. Dështimi në përputhje me detyrimin e raportimit, siç përcaktohet në paragrafin 3 të nenit 25;</p> <p>1.12. Dështimi për të përmbushur detyrimin e bashkëpunimit në bazë të paragrafit 4 të nenit 35 pas njoftimi zyrtar me shkrim nga NjIF-K, BQK ose mbikëqyrësit e tjerë sektorial;</p> <p>1.13. Mosrespektimi i detyrimit për mbajtjen e të dhënave, siç përcaktohet në nenin 20;</p> <p>1.14. Dështimi në përputhje me detyrimin e krijimit të organeve adekuate të kontrollit për implementimin e obligimeve të cilat dalin nga ky ligj dhe testimin e sistemit të raportimit dhe identifikimit, siç përcaktohet në paragrafin 2.6 të neni 17;</p> <p>1.15. Mosrespektimi i detyrimeve mbi marrjen e informacionit mbi pagesat për transferet elektronike siç përcaktohet në nenin 24;</p> <p>1.16. Dështimi në përputhje me detyrimin e njoftimit të NjIF-K për emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë të subjektit raportues ose zëvendësit të tij, ose refuzimit për të adresuar kundërshtimet ose vërejtjet e bëra sipas kushteve të nenit 21;</p>	<p>paragraph 9 of Article 19;</p> <p>1.11. Failure to comply with the obligation of reporting, as defined under the terms of paragraph 3 of Article 25;</p> <p>1.12. Failure to comply with the obligation of co-operation under the terms of paragraph 4 of Article 35, following the official written notice from FIU-K, CBK or other sectorial supervisors;</p> <p>1.13. Failure to comply with the obligation of record keeping, under the terms of Article 20;</p> <p>1.14. Failure to comply with the obligation of establishing adequate bodies to regulate internal control for the implementation of the obligations defined in this law and testing of the reporting and identification system, as defined under the terms of paragraph 2.6 or article 17;</p> <p>1.15. Failure to comply with the obligations on obtaining information on the payments for wire transfers, as defined under the terms of Article 24;</p> <p>1.16. Failure to comply with the obligation of notifying FIU-K on appointment of the compliance officer of the reporting entity or his/her deputy, or refusal to address objections or remarks made in accordance with terms of article 21;</p>	<p>9 člana 19;</p> <p>1.11. Neuspunjavanje obaveze izveštavanja, kao što je propisano u stavu 3. stav 25;</p> <p>1.12. Neuspunjavanje obaveze o saradnji u skladu sa stavom 4. člana 35. posle zvaničnog pismenog obaveštenja o FOJ-K, CBK ili drugih sektorskih nadzornika;</p> <p>1.13. Nepoštovanje obaveze za držanje evidencija i podataka, kao što je predviđeno u članu 20;</p> <p>1.14. Neuspunjavanje obaveza uspostavljanja odgovarajućih organa kontrole i testiranje sistema za izveštavanje i identifikaciju, kao što je predviđeno u stavu 2.6. člana 17;</p> <p>1.15. Nepoštovanje obaveze za dobijanje informacija o elektronskim transakcijama i isplatama kao što je utvrđeno u stavu 24;</p> <p>1.16. Neispunjavanja obaveze u skladu sa obavezom o informisanju FOJ-K za imenovanje službenika usaglašenosti izvještajnog subjekta ili njegovog zamenika, ili odbijanje dostavljanja žalbi ili prigovora na razmotranje u skladu sa odredbama člana 21;</p>
--	--	---

<p>1.17. Dështimi në përputhje me detyrimin për të siguruar zyrtarit të pajtueshmërisë kushtet e nevojshme për ushtrimin e funksionit, siç përcaktohet në paragrafin 4 të nenit 21;</p> <p>1.18. Dështimi në përputhje me detyrimin e trajnimit të punonjësve, sipas paragrafit 2.5 të nenit 17;</p> <p>1.19. Dështimi në përputhje me detyrimin e miratimit dhe vënies në dispozicion të NjIF-K politikat dhe procedurat e duhura dhe të përditësuar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, siç përcaktohet në paragrafin 3 të nenit 24;</p> <p>1.20. Dështimi në përputhje me detyrimin e aplikimit të masave në lidhje me degët dhe filialet shumicë në pronësi të vendosura në vende të treta, siç përcaktohet në nenin 24;</p> <p>1.21. Dështimi në përputhje me detyrimin për të ndërmarrë masa për përmirësim pas njoftimit zyrtar të përcaktuar në 7.1. të nenit 34, kur ka mosgatishmëria për të përmbushur rekomandimet;</p> <p>1.22. Hyrja ose vazhdimi i marrëdhënies së biznesit apo ekzekutimi i pagesave dhe transaksioneve të ndaluara sipas këtij ligji;</p>	<p>1.17. Failure to comply with the obligation to provide the compliance officer with the necessary conditions for exercising the function, as defined under the terms of paragraph 4 of Article 21;</p> <p>1.18. Failure to comply with the obligation of training the employees, as defined under the terms of paragraph 2.5 or Article 17;</p> <p>1.19. Failure to comply with the obligation of approval and making available to FIU-K the necessary updated policies and procedures for prevention of money laundering and terrorist financing, as defined under the terms of paragraph 3 or Article 24;</p> <p>1.20. Failure to comply with the obligation of the application of measures in relation to majority branches and ownership subsidiaries located in third countries as defined under the terms of Article 24;</p> <p>1.21. Failure to comply with the obligation to undertake remedial measures following written formal request as set out in paragraph 7.1 of Article 34, when there is non-readiness to fulfil the recommendations;</p> <p>1.22. Entering or continuing the business relationship or the execution of payment and transactions which are prohibited by this Law;</p>	<p>1.17. Neispunjavanje obavezeu skladu sa obavezom da se službeniku usaglašavnja obezbede neophodni uslovi za vršenje njegove funkcije, kao što je utvrđeno u stavu 4. člana 21;</p> <p>1.18. Neispunjavanje obaveze u skladu sa obavezom obuke zaposlenih, prema stavu 2.5. člana 17;</p> <p>1.19. Neispunjavanje obavezeu skladu sa obavezom usvajanja i stavljanja na raspolaganje FOJ-K odgovarajuće svakodnevnne politike i procedure za sprečavanje pranja novca i finansiranja terorizma, kao što je predviđeno u stavu 3. člana 24;</p> <p>1.20. Neispunjavanja obaveze u skladu sa obavezom o primeni mera koje se odnose na ogranke i filijale i većinskim filijalama koje se nalaze u trećim zemljama, kao što je predviđeno u članu 24;</p> <p>1.21. Neispunjavanja obaveze u skladu sa obavezom za preduzimanje mera za poboljšanje posle zvaničnog obaveštenja navedenog u stavu 7.1. Član 34., kada ima nespremnosti za ispunjenje preporuka;</p> <p>1.22. Stupanje ili nastavak poslovnog odnosa ili izvršenje plaćanja i transakcija zabranjenih ovim zakonom;</p>
--	--	--

